



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 891/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Gyltene Sylejmani kryesuese Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevci anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me apelet e parashtruara nga Anoton Shala, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Gjakovë, nga radhët e subjektit politik Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës, dega në Gjakovë, paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohen si të pabazuara apelet e parashtruara nga Anoton Shala, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Gjakovë, nga radhët e subjektit politik Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës, dega në Gjakovë, me shenjën ZL.Anr.891/2017, ZL.Anr.892/2017, ZL.Anr.893/2017, ZL.Anr.894/2017, të datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

Paneli i PZAP-it, ka pranuar apelet ZL.Anr.891/2017, ZL.Anr.892/2017, ZL.Anr.893/2017, ZL.Anr.894/2017, të datës 10.11.2017, nga parashtruesi i apeleve Anoton Shala, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Gjakovë, nga radhët e subjektit politik Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës, dega në Gjakovë, pretendon votat e tij i janë bartur kandidatëve tjerë.

Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar apelet e lartcekura dhe i trajton si një apel i evidentuar me ZL.Anr.891/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për katër apelet që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, dhe se ato apele të trajtohen me një vendim i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës .

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apelet janë të pabazuara

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore gjeti se parashtuesi në apel me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar pretendimet e tij. Prandaj, Paneli apelin e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindëse pasi që nuk i plotësoj kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar dhe si të tillë e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.891/2017 më datën 12.11.2017.

Kryesuesi i Panelit
Gylfene Sylejmani



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*